

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**  
**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*”Blerje lende djegese per ngrohje pellet (F.V kaldaja dhe mirëmbajtje) per nevoja te S.U.O.GJ. Koco Gliozheni – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 2 vjeçar (24muaj).*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*09110000-3- Lende ngrohese te ngurta*

**VLERA E FONDIT LIMIT:** Vlera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen per periudhen 12 mujore–**39,820,800 ( tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e njëzet mijë e tetëqind ) lekë pa TVSH.** , vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor S.U.O.GJ.”Koço Gliozheni” ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Formulari i Sigurimit te Ofertes sipas Shtojces 3;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% të fondit limit per te cilin konkuron në vlerën prej 15,928,320 lekë pa tvsh.

Per kete operatori ekonomik duhet te dorezoje vertetim leshuar nga Dega e tatim Taksave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit është: **39,820,800 ( tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e njëzet mijë e tetëqind ) lekë pa TVSH.**

**Jo me e madhe se 40% e 39,820,800 = 15,928,320 lekë leke pa TVSH.**

Pra vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar (2019,2020,2021) duhet të jetë jo më e madhe se **15,928,320** leke pa TVSH.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2.1.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e tre viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.*

*Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

## **2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të

**madhe se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit , nga data e zhvillimit të procedurës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

Duke qene se edhe per kete sezon nuk kemi siguruar burim alternativ ngrohje, mbeshtetur ne kerkesen e Sektorit Teknik, do te procedohet si deri me sot me prokurim blerje pellet me kaldaja ne pronesi te furnitoreve.

**2.3.1** Drejtoria e S.U.O.Gj”Koco Gliozheni” me qellim sigurimin e ngrohjes ne ambjentet e Spitalit (ambjente te cilat jane 15560 m3 (pesembedhete mije e peseqinde e gjashtedhete metra kub), operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me kontrate qeraje 2 (dy) copë kaldaja me pellet .

**2.3.2** Kaldajat duhet te jene te pajisura me shnek dhe te shoqeruara me certifikatat perkatese.

Paisjet teknike ( kaldajat ) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me kontrata qeraje noteriale.

**2.3.3** Për paisjet teknike ne pronesi, (kaldajat ) operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi ose kontratë shitblerje noteriale.

**2.3.4** Për paisjet teknike të marra me qera (kaldajat), duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje). Kontrata e qerave duhet te jete e vlefshme per periudhen e mbulimit te sherbimit.

**2.3.5** Kaldajat duhet te jene te pajisura me certifikate konformiteti te Inspektimit te Pajisjeve nen presion me vatra zjarri.

**2.3.6** Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet te beje montimin me shpenzimet e veta te paisjeve djegese te pelletit dhe te beje mirembajtjen e tyre po me shpenzimet e veta, nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj, si dhe trajnimin e personelit spitalor qe do te punoje ne keto kaldaja.

**2.3.7** Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij, të marrë përsipër montimin e kaldajave menjëherë mbas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

**2.3.8** Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij, të marrë përsipër riparimin e kaldajave dhe djegësit ( bruciatorit ) në rast të ndonjë difekti të mundshëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pronesi ose me kontrate qeraje te pakten 1(nje) automjet 5-10 ton te pershtatshem per transportin e lendes djegese.

Per te vertetuar kete OE ofertues duhet te paraqese si me poshte:

- Çertifikaten e pronësisë /ose kontrate qeraje noteriale.
- Leja e Qarkullimit.
- Polica e Sigurimit te detyrueshem te mjeteve motorrike.
- Kontrolli Teknik Vjetor – akt kolaudimin.
- Per automjetet e marra me kontrate noteriale qeraje OE duhet te kete kontraten e qerase te shoqeruar me aktin e pronesise ne emer te qiradhenesit, dokumentacionin e siperkerkuar dhe afati I marrjes me qera te mbuloje afatin e realizimit te procedures.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

#### **2.4. Kërkesa të tjera për kualifikim.**

**2.4.1**Operatori ekonomik ne rastin kur eshte prodhues i lendes djegese pellet, duhet te paraqese licencë të vlefshme:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”/ ose ekuivalente.
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” ose ekuivalente.
- BS OHSAS 18001:2007 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalente.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga nje organ I vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar I akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga RSH.

**2.4.2** Operatori ekonomik ne rastin kur nuk eshte prodhues i lendes djegese pellet, duhet te paraqese kontrata furnizimi noteriale me prodhues te lendes djegese pellet, ose **edhe kontrata me distributor te autorizuar nga prodhuesi**. Pra AK lejon mundësinë qe ofertuesi të paraqese kontratata furnizimi edhe nga distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Ofertuesi duhet te vërtetoje lidhjen e distributorit me prodhuesin.

Gjitashtu për rastet kur OE nuk është prodhues, duhet te paraqese nje vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe AK ka të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatave te kerkuara.

**2.4.3** Cdo furnizim duhet te shoqerohet me certifikaten e cilesise, te peletit sipas kriterëve te percaktuara nga ana e Autoriteti Kontraktor.

**2.4.4** Lenda djegese e kerkuar per furnizim do te levrohen nga kontraktuesi sipas kerkesave.

**2.4.5** Kontraktuesi duhet te siguroje furnizim te vazhdueshem per 24 ore ne dite dhe sipas cilesise se kerkuar.

**2.4.6** Furnizimi me pellet nga ana e subjektit kontraktues do te behet prej ores 08:00 deri ne oren 16:00, nga dita e hene ne te premte.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriterë të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 70, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 41, pika 5 me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Kaldajat do te instalohen si me poshte ;

Te salla kaldajave te S.U.O.GJ” Koço GLOZHENI” do te instalohen dy kaldaja me fuqi nje jo me pak se 500 kw, qe do te ngrohe ambjentet e godines se spitalit do te ngrohin nje siperfaqe prej 15560 (pesembedhjete mije e pese qinde e gjashtedhjete) metra kub.

Kaldajat me fuqi jo me pak se 500 kw qe duhet te plotesoje minimalisht te dhenat si me poshte;

- |                               |                           |
|-------------------------------|---------------------------|
| ○ Fuqia min/max e punes       | jo me pak se 392 - 530 kw |
| ○ Fuqia termike nominale      | jo me pak se 500 kw       |
| ○ Fuqia termike e kthyer      | jo me pak se 459 kw       |
| ○ tensioni i punes (elektrik) | jo me pak se 380 v        |
| ○ Fuqia motorrike             | jo me pak se 1100 W       |
| ○ Rendimenti                  | jo me pak se 87 %         |

- Presioni i ujit jo me pak se 1,5 - 3,8 bar
- Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m3

**Te dhenat teknike te pellet druri te jene si me poshte;**

Nr	Treguesit	Njesia	parametrat
1	Densiteti	Kg/m <sup>3</sup>	650
2	Fuqia kalorifike	Kw	4 – 4.2
3	Mbetja mbas djegjes (hirit)	%	0.1 – 0.2
4	Permbajtja e sqfurit	%	0.0025 – 0.0030
5	Ambalazhimi	Thase	15 kg
6	Lageshtira	%	8.5 – 9.5
7	Dimensioni	mm	6 - 8
8	Gjatesia	mm	30 – 40

Çdo furnizim duhet të shoqerohet me çertifikaten e cilësisë, të pelletit sipas kriterëve të përcaktuara nga ana e AK.

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 41 “Kerkesat e vecanta per kontratat e mallrave”, pika 2 dhe 3.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Njesia Prokurimit